



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Praktike profesionale**

**Lënda: Kurs Special 5 (Realitete të fushës televizive në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni)**

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Alban Tartari
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 2 leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	E detyruar
<i>Viti/semestri:</i>	III/I

**Përshkrimi:**

Kjo lëndë trajton në terma shkencorë dhe praktikë televizionet shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Televizioni do të shihet në tërësinë e tij funksionale, dhe jo thjesht në këndvështrimin e produksioneve të tij gazetareske. Kursi special synon tu japë studentëve një tablo të plotë se ç'është televizioni teorikisht dhe në fakt si shfaqet ai realisht në hapsirën shqiptare në kohën që jetojmë. Cilat janë transformimet e televizionit nisur edhe nga zhvillimet teknologjike e veçanërisht nga përparimi dhe shtrirja e internetit. Sa ka ndryshuar televizioni klasik i 25 viteve më parë në funksionimin e tij? Çfarë ka ndryshuar në teknologji, organizim dhe departamentet e produksionit? Pse sektori i lajmeve nuk mund të jetë më ai i para 25 viteve? A ka ndryshime strukturore-organizatve mes TV publik dhe atyre privatë? Si po kalon televizioni në internet dhe çfarë është teknologjia e re IPTV?

**Temat e leksioneve:**

1. Televizioni në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Si është ndërtuar tregu televiziv?
2. Struktura televizive. Cilët janë elementët përbërës të strukturës televizive. Një krahasim edhe me televizionet evropiane. Bashkëpunimi me radion.
3. Çfarë është departamenti teknik? Sa ka ndryshuar teknologjia në 25 vitet e fundit. Nga transmetimet tokësore me përforcues te sateliti dhe aktualisht te interneti.
4. Çfarë është departamenti i prodhimeve? Sfidat e televizionit: produksione të vazhdueshme vendore. Balanca mes produksioneve vendase dhe atyre te blera? Prodhime në TV apo kontrata me agjenci prodhimi në vend?
5. Çfarë është departamenti i lajmeve? Si ka ndryshuar raportimi i lajmeve në 25 vite. Transmetimet direkte, raportimi nga hapsirat më të larta të Shqipërisë dhe nga jashtë vendit.
6. Si lindën departamentet e produksioneve në internet? Nga teleteksti te faqja në rrjet, nga lajmet me faks te përdorimi i rrjeteve sociale. Sa ka ndryshuar raportimi në televizionin e kohëve që jetojmë.
7. Shërbimet ndihmëse në televizion. Rëndësia e punës në grup. Ndërtimi i komunikimit mes pjesëtarëve të një ekipi televiziv.
8. Sfidat e reja të televizionit të tregun mediatic. A po e ndryshon interneti televizionin? Ndryshimi i produksioneve televizive dhe përshtatja edhe për internetin.
9. Cila është balanca: TV furnizon internetin, apo interneti TV?
10. Si matet shikueshmëria televizive? Si përcaktohen audienat?

11. Çfarë është teknologjia IPTV? Cili është ndryshimi i transmetimeve tokësore dixhitale dhe televizionit përmes protokollit të internetit? A po dominojnë operatorët e telekomunikacionit mbi TV apo TV mbi këta operatorë?
12. Çfarë është VoD (video on demand). A janë në gjendje televizionet shqiptare të ofrojnë këtë shërbim? Çfarë ndryshon VoD në shërbimet televizive?
13. YouTube, Vimeo, Vine, DailyMotion etj, sa është ndikimi i tyre mbi televizionin? Shërbimet e Hulu, Netflix, konkurrentët kryesorë të televizionit klasik.
14. Televizioni në celular. Aplikacionet e Google, Apple dhe Microsoft për televizionin. Kush do e fitojë betejën e konkurrencës? A do mund ekrani i vogël i celularit 'të mençur' ta zëvendësojë ekranin e madh të shtëpisë?
15. A po bëhet televizioni më interaktiv duke përfshirë audiencat në produksinet e tij?

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:	70% të seminareve
- Pjesëmarrja aktive në klasë	20% e notës
-Detyrë/prezantim në klasë	80% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. Francis Balle, *Mediat dhe Shoqëritë*, Botimet Papirus, Tiranë, 2011 (Faqe 301-465)
2. Eric Scherer, *A na duhen më gazetarët*, Botimet Papirus, Tiranë 2010 (Faqe 79-107)
3. Marcello Foa, *Magjistarët e Lajmit*. Botimet Onufri, Tiranë, 2014 (Faqe 189-193)
4. Eric Maigret, *Sciologjia e Komunikimit dhe e Mediave*, Botimet Uet dhe Papirus, Tiranë, 2010, (Faqe 311-323)
5. Frederic Barbier dhe Catherina Bartho Lavenir, *Historia e Medias*, Instituti Shqiptar i Medias, (faqe 241-281)